



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 771 Prot.

Tiranë, më datë 21.06.2022

**VENDIM**  
**Nr. 271, datë 21.06.2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.06.2022:

**VENDOSI:**

1. Shtyrje vendimmarje për projektin “Rikonstruksion dhe ritrajtim 2 kate mbi objektin ekzistues 1 kat, strukturë akomoduese BB”, Brenda kufirit Zona arkeologjike “A”, Elbasan, me aplikues Piro Karanxha dhe zhvillues Besmir Guri;
  - Të plotësohet projekti me gjendjen faktike dhe relacion teknik nga inxhinieri konstruktor në lidhje me gjendjen e themeleve,
  - Të plotësohet me projektin konstruktiv të themeleve të propozuara, pa cënuar nëntokën
  - Lartësia maksimale e objektit të mos kalojë lartësinë e mureve të kalasë;
2. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Rudina ZOTO**

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**

